



THIRRJE PËR EKSPERT

Projekti: “Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi, Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 nën Instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)”.

Objektivi: Mbajtja e një workshop-i 1 (një) ditor për mentorët/punëmarrës të subjekteve tregtare në sektorët hoteleri-turizëm, gastronomi, artizanat, ICT dhe sektorë të tjerë të ndërlidhur. Eksperti i jashtëm, do të trajnojë 10 mentor për trajnimin në punë dhe mentorimin e pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit në trajnim janë përzgjedhur më parë dhe kanë aftësi praktike në punën e tyre të përditshme. Realizimi i këtij workshopi synon dhënien e informacionit të nevojshëm mentorëve, në mënyrë që të ofrojnë një trajnim sa më cilësor në punë për të trajnuarit e përzgjedhur.

Detyrat e ekspertit të jashtëm:

1. Të përgatisë një material/guidë me informacione të nevojshme për mentorët, të këshilluar më parë me AIDA-n dhe organizatat partnere, për realizimin e workshop-it 1 (një) ditor me 10 mentorët. Gjatë workshop-it, do të diskutohet rreth nevojave që punëdhënësit kanë në punë dhe përcjelljen e tyre tek individët që do të trajnohen, me qëllim që të fitojnë aftësi të reja për punë dhe të integrohen në tregun e punës;
2. Të japë udhëzime për trajnimin në punë që do të përfshijë të paktën kohëzgjatjen, detyrat dhe fushat që do të mbulohen, pikat që duhen arritur dhe monitoruar;
3. Të hartojë dhe përgatisë modele raportimi/time sheet, që do përdoren në vijim nga mentorët për të raportuar mbi ecurinë e të trajnuarve në vendin e punës (duke saktësuar elemente që lidhen me kohën e shpenzuar, efektivitetin e trajnimit dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme në procesin e trajnimit).

Kohëzgjatja:

Realizimi i një seminari/workshop-i 1(një) ditor, për t’u zhvilluar brenda muajit shtator 2023.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:

1. Të zotërojë arsimin e lartë;
2. Të zotërojë 3-5 vite eksperiencë në fushën e trajnimeve, në përputhje me objektin e kësaj thirrjeje.





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Diploma e shkollës së lartë (Fotokopje e noterizuar);
2. Dokumentacioni që vërteton eksperiencën të mëparshme në punë të ngjashme/kontratat;
3. Fotokopje e librezës së punës që vërteton vitet e eksperiencës/vërtetim nga punëdhënësi;
4. Jetëshkrimi/Curriculum Vitae;
5. Kopje ID/Pasaportë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

- | | |
|---|----------|
| 1. Diploma e shkollës së lartë | 40 pikë; |
| 2. Vitet e eksperiencës | 30 pikë; |
| 3. Dokumentacioni që vërteton eksperiencën të mëparshme | 20 pikë; |
| 4. Jetëshkrimi/Curriculum Vitae | 10 pikë. |



Funded by
the European Union

